

# Fol me mua dhe më dëgjo mua!



12 udhëzime se si  
ne mund t`i ndihmojmë  
fëmijët tanë  
në mësimin e të folurit

Një broshurë  
për prindërit  
(e fëmijëve të moshës  
nga 0 deri në 5 vjeç)

## Të dhëna mbi botimin

### *Ideja dhe koncepti*

© okay, të jetuarit  
bashkë / Qendra e projekteve  
për emigrimin dhe integrimin,  
**Vorarlberg (Shoqata Veprim  
Bashkëpunim), Dornbirn  
(Austri) Nëntor 2008**

*Materialet bazë të përmbajtjes*  
Elisabeth Allgäuer-Hackl  
Gerlinde Sammer  
Elizabet Hintner

*Teksti*  
Elisabeth Allgäuer-Hackl  
Lidwina Boso

*Redaktimi*  
Eva Grabherr

*Përmbajtja themelore e kësaj  
broshure është përpunuar  
në 2008 në kuadrin e programit  
«më shumë gjuhë. Nxitja e  
hershme e gjuhës dhe  
shumëgjuhësia – një detyrë  
e madhe për familjen dhe  
institucionet e arsimimit të  
hershëm» me porosi të landit  
të Vorarlbergut.  
*Informacione mbi programin:*  
[www.okay-line.at](http://www.okay-line.at)*

*Leja për përdorimin e veprës  
dhe adoptimi për Zvicrën*  
Kantoni i Lucernit, Qendra e  
shërbimit social dhe shoqëror,  
Qendra e specializuar për  
pyetjet e shoqërisë

*Përshtatjet e tekstit*  
Sabine Schoch  
Heinz Spichtig-Bonetta

*Përkthimi shqip*  
Ermira Orucevic-Tuzi  
lingua suisse («Institucion  
dhe oferta për këshillimin dhe  
mbështetjen e prindërve»)

*Grafiku*  
Susanne Gmür, Lucern

*Mbështetur nëpërmjet të Kreditit  
për Integrin të Federatës*

Lucern, Maj 2010

*Marrë më tej nga Fachstelle  
Integration Graubünden (Vendi i  
specializuar për integrimin) në  
kuadrin e programit të nxitjes së  
integrimit 2011*

Chur, qershor 2011

# Të dashur prindër,

urime të përzemërtë për lindjen e fëmijës tuaj. Koha e gjatë e pritjes mbaroi. Më në fund ju mund ta mbani fëmijën tuaj në krahë. Ju keni marrë me siguri shumë urime nga të afërmit të njohurit dhe nga rrethi shoqëror. Njëkohësisht ju e keni pyetur veten ndoshta aty këtu, se si do të jetë rruga e jetës e fëmijës tuaj dhe se si mund ta shoqëroni ju atë më së miri.

Ju si prindër doni më të mirën për fëmijën tuaj. Por shpesh në punën e edukimit njeriu gjendet përpara detyrave të reja, ndihet nganjëherë paksa i mbingarkuar, kur bëhet fjalë, për marrjen e vendimive për mirëqënen e fëmijës. Kjo ju ndodh kështu shumë prindërve.

Në një çështje të rëndësishme ne duam t'ju ndihmojmë juve me anë të kësaj broshure. «Fol me mua dhe më dëgjo mua!» ka si qëllim t'ju informojë juve, se si ta ndihmoni mirë fëmijën tuaj në vitet e para të jetës për të mësuar të flasë.

Vitet e para të jetës janë një periudhë shumë e rëndësishme për zhvillimin gjuhësor të një njeriu, dhe ju si prindër mund ta përkrahni mirë fëmijën tuaj në mësimin e të folurit dhe në mësimin e gjuhës. Zotërimi i mirë i gjuhës dhe i gjuhëve, është sot dhe në të ardhmen i rëndësishëm për jetën në shoqërinë tonë dhe për një ekzistencë të mirë në profesion.

Nëse ju vetë nuk jeni rritur me gjuhën gjermane ose keni mësuar gjermanisht si të rritur, ju pyesni ndoshta veten, si mund ta përkrahni ju mirë fëmijën tuaj në mësimin e të folurit. Për këtë ju gjeni në broshurën tonë shumë informacione që të ndihmojnë. Ajo informon - edhe me shumë shembuj praktikë -, se si fëmijët mund të rriten mirë me dy ose edhe më shumë gjuhë.

Të përkrahësh fëmijët në mësimin e të folurit nuk është një vepër arti. Këtë do ta vëreni, kur ta lexoni këtë broshurë. Por kjo kërkon vëmendjen dhe aktivitetin tuaj. Prandaj lexojeni këtë broshurë jo vetëm një herë. Të jetë ajo si shoqëruese për ju. Ju do të zbuloni vazhdimisht gjëra, që do t'ju ndihmojnë juve për një nxitje të mirë të fëmijës tuaj në vitet e para të jetës.

Shumë kënaqësi me fëmijën tuaj dhe gjithë të mirat!

# Përshëndetje, ju nuk mund të më shikoni mua, por unë mund t'ju dëgjoj juve!

1

A e keni ditur ju,  
që ...

ju mund të nxisni një  
zhvillim të mirë gjuhësor  
të fëmijës tuaj qysh në  
shtatzani?

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë?

Qysh pas muajit të 4. të shtatzanisë fillon një fëmijë, të perceptojë zëra; para së gjithash zérin e nënës.

Melodia gjuhësore e gjuhës së nënës ngulitet tek fëmija qysh para lindjes. Edhe muzika dhe zhurmat ndikojnë qysh në barkun e nënës.

Prindërit janë në vitet e para të jetës shembujt më të rëndësishëm për fëmijën e tyre. Për këtë është e rëndësishme, që qysh gjatë shtatzanisë të mendohet për atë, se në cilën gjuhë ose ndoshta në cilët gjuhë duan prindërit të flasin me fëmijën e tyre.

## Shembuj për jetën e përditshme: Çfarë mund të bëni ju konkretisht për fëmijën tuaj!

Tregojini fëmijës tuaj qysh gjatë shtatzanisë për botën tuaj. Tregojini atij çfarë ju intereson juve.


Për të vendosur, se në cilën gjuhë (ose në cilat gjuhë) do të flisni ju në shtëpi me fëmijën tuaj, do t'ju ndihmojnë mendimet që vijojnë:

Flisni ju me fëmijën tuaj në gjuhën, në të cilën ju e ndjeni veten mirë dhe që ju e zotëroni më së miri. Në këtë gjuhë ju mund t'i jepni fëmijës tuaj edhe thesarin gjuhësor më të madh. Me këtë ju ndërtoni një bazë të mirë për të gjitha gjuhët e tjera, që fëmija juaj do të mësojë akoma gjatë jetës së tij.

Në rast se ju si prindëri flisni mirë gjuhë të ndryshme, atëherë kjo është një situatë fillestare shumë e vlefshme për fëmijën tuaj. Secili nga prindërit mundet atëherë të flasë me fëmijën gjuhën e vet më të fortë. Fëmija juaj ka kështu shembuj gjuhësor të mirë në dy gjuhë.

Pavarësisht se për cilën gjuhë familjare ju vendosni, shumë e rëndësishme është, që fëmija juaj ta mësojë edhe gjuhën e vendit gjermanishten. Ka nevojë për njohuri të mira të gjermanishtes, që të ndihet mirë këtu, të gjejë shokë e shoqe dhe për të fituar një arsimim të mirë. Fëmija juaj mund ta mësojë mirë gjuhën gjermane, edhe në rast se ju në shtëpi në jetën e përditshme flisni një gjuhë tjetër me të.

# Gjuha e mamilët është okay! – Gjuha e babit është okay!



A e keni ditur ju,  
që ...

fëmija juaj mëson më  
shumë, në rast se ju flisni  
me të gjuhën, që është  
më e afërt për ju?

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë?

Për zhvillimin e përgjithshëm dhe për atë gjuhësor është një marrëdhënie e mirë emocionale një bazë e rëndësishme. Prej andej fëmijët e ndjejnë, nëse prindërit e tij flasin me të një gjuhë, në të cilën ata ndihen mirë dhe të sigurtë.

Sa më mirë që ta flasin prindërit gjuhën, që ata transmetojnë, aq më mirë është edhe për zhvillimin gjuhësor të fëmijës.

Të flasësh mirë gjuhën e nënës tënde, është baza më e mirë, për të mësuar gjuhë të tjera. Secila gjuhë përmban dije mbi botën, që ne juas transmetojmë fëmijëve me anë të gjuhës.

## Shembuj për jetën e përditshme: Çfarë mund të bëni ju konkretisht për fëmijën tuaj!


Flisni ju me fëmijën tuaj në gjuhën ose në dialektin, që ju e zotëroni më mirë.

Flisni shumë me fëmijën tuaj, dhe i jepni edhe atij shumë kohë, për të folur vetë.

Tregimet, këngët ose lojrat e fëmijëve nga vendlindja juaj i tregojnë fëmijës diçka mbi ju dhe mbi prejardhjen tuaj. Kjo është e rëndësishme, sepse fëmijëve iu nevojiten edhe këto rrënje.

Hapini fëmijës tuaj rrugë pozitive edhe për gjuhët e tjera. Futuni me një shembull të mirë në këtë drejtim! Në rast se ju mbani një qënim pozitiv ndaj gjuhëve, ndaj mësimit të gjuhëve, ndaj kultivimit të gjuhës tuaj dhe të gjermanishtes, kjo do të kalojë edhe tek fëmija juaj.

# Unë jam i shtrenjtë, kështu siç jam!



A e keni ditur ju,  
që ...

vetëbesimi është baza  
më e mirë për zhvillimin  
gjuhësor të fëmijës tuaj?

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë?

Një fëmijë ka nevojë në zhvillimin e tij dhe në mësimin e të folurit veçanërisht përkushtimin e prindërve. Ai duhet të përjetojë dhe të ndjejë, që ata e duan dhe e pranojnë siç është, në mënyrë që ta zhvillojë vetëbesimin. Kjo energji është çelësi për zhvillimin e tij.

Një fëmijë ka nevojë edhe për siguri. Ai duhet të dijë, kur prindërit përmomentin nuk kanë kohë, përsë ato në atë moment nuk mund ta dëgjojnë atë dhe kur mund t'i përkushtohen përsëri atij. Ai duhet ta mësojë, përsë diçka duhet të jetë kështu ose përsë nuk është e mundur.

## Shembuj për jetën e përditshme: Çfarë mund të bëni ju konkretisht për fëmijën tuaj!


Jeta e përditshme ofron shumë mundësi, për të komunikuar me fëmijën tuaj dhe për të marrë pjesë në biseda. Me këtë ju mund dhe duhet të filloni në ditën e parë të jetës.

Tregojini atij, se çfarë po bëni ju momentalisht me të. Reagoni ju ndaj tingujeve të tij dhe i shprehni atij, që ju gëzoheni për këto.

Mos u përpinqi për ta pajtuar fëmijën tuaj për kohë të pacaktuar. Kjo e bën të pasigurtë atë. Mbajeni premtimin, që ju i jepni atij.

Dëgjojeni fëmijën tuaj me vëmendje, flisni me atë dhe lavdërojeni atë! Lëreni fëmijën tuaj të tregojë, çfarë ka përjetuar. Lëreni të flasë deri në fund dhe mos e ndërprisni atë.





# Në kokën time kanë edhe dy ose më shumë gjuhë vend!

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë?

Fëmijët munden pa probleme të rriten me dy ose më shumë gjuhë – Miliona fëmijë jetojnë në vend, ku në jetën e përditshme përdoren shumë gjuhë. Zhvillimi i fëmijës nuk pëson dëmtime për këtë shkak.

Fëmijët me shumë gjuhë zhvillohen ashtu si edhe ato me një gjuhë – dhe pikërisht në mënyra të ndryshme. Disa flasin herët, të tjerët më vonë, disa flasin shumë, disa më pak.

Zhvillimi gjuhësor i fëmijës është dinamik. Fëmija është gjithnjë në rrugë e sipër, mëson gjëra të reja dhe integrat të vjetrat. Përzierja e gjuhëve i përket këtij zhvillimi.

Vëmendja dhe një bisedë me mjekun ose mjeken, një ekspert ose një eksperte është e nevojshme, në rast se një fëmijë për kohë të gjatë nuk bën më përparime ose pushon së foluri.

Kur fëmijët rriten me më shumë se vetëm një gjuhë, kanë nevojë për një përkrahje të vetëdijeshme në të gjitha gjuhët. Prindërit mund të kontribuojnë shumë në mënyra krejt të ndryshme, që fëmijëve t'iu shkojë mirë kjo gjë.

A e keni ditur ju, që ...

për fëmijët nuk është mbingarkesë, në rast se ato rriten me dy ose më shumë gjuhë?

4

## Shembuj për jetën e përditshme: Çfarë mund të bëni ju konkretisht për fëmijën tuaj!


Ju e edukoni fëmijën tuaj në gjuhën tuaj amtare, për shembull turqisht, bosnisht/kroatisht/serbisht, kurdisht, rusisht, spanjisht..., dhe gjuha e mjedisit është gjermanishtja?

Atëherë flisni ju vetë sa më shumë në gjuhën tuaj me fëmijën. Por ju kujdesuni të keni edhe kontakte me familjet përrreth, në të cilat flitet gjermanisht. Përkraheni fëmijën tuaj, të gjejë shokë e shoqe që flasin gjermanisht. Dërgojeni fëmijën tuaj në një grup lojtrash ose në kopësht. Kjo e nxit zhvillimin e tij. Sa më herët që të ketë kontakt me fëmijët që flasin gjermanisht, aq më shpejt dhe më lehtë do ta mësojë gjuhën e dytë.

Ju si prindër zotëroni dy gjuhë shumë mirë? Atëherë fëmija ka mundësinë, të mësojë një «gjuhë të mamit» dhe një «gjuhë të babit». Të keni parasysh, se ka rregulla të qarta gjuhësore. Para së gjithash kjo është e rendësishme për fëmijët e vegjël. Mami flet në «gjuhën e mamit» me të dhe babi në «gjuhën e babit». Kështu fëmija mund të bëjë lidhjen e një personi të caktuar me një gjuhë të caktuar. Kjo e ndihmon atë, t'i rendisë qartë gjuhët në kokën e tij.

(Përdorimi i gjuhëve mund të renditet edhe sipas situatave: Në jetën e përditshme flitet njëra gjuhë, kurse gjatë ngrënies së darkës ose gjatë bërjes së detyrave të shtëpisë ose edhe gjatë «tregimeve të para gjumit» gjuha tjetër. «Krijimi i ishujve të gjuhës» quhet kjo mënyrë.)

A do të rritet fëmija juaj me një, dy ose tri gjuhë, e rendësishme për secilin rast është kjo që vijon: Flisni ju shpesh me fëmijën tuaj, tëjeni dëgjues të mirë dhe të durueshëm dhe lavdërojeni ju fëmijën!



# Fol me mua dhe më dëgjo mua!

A e keni ditur ju,  
që ...

vetëm fëmijët, që  
dëgjojnë mirë, mund të  
mësojnë edhe të flasin  
mirë? A e keni ditu ju  
përveç kësaj, që një  
foshnje kur i flitet me  
një bazë zëri më të lartë  
reagon më shpejt?

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë?

Dëgjimi i mirë është një premisë për një të folur të mirë. Një foshnje e shëndetshme zakonisht duhet pas gjashtë muajve të fillojë të belbëzojë gjithnjë e në rritje, të imitojë tinguj dhe të «flasë» me vete, përndryshe duhet të kontrollohet njëherë aftësia e dëgjimit.

Edhe foshnjet me dëgjim të dëmtuar lëshojnë tinguj nga vetja në muajt e parë, por pastaj bëhen gjithnjë e më të heshtur.

Të folurit me një zë disi më të lartë rrit vëmendjen e foshnjës. Kështu mund të fitohet qysh herët një buzëqeshje e parë nga foshnja.

## Shembuj për jetën e përditshme: Çfarë mund të bëni ju konkretisht për fëmijën tuaj!

Vëzhgojeni fëmijën tuaj para së gjithash pas muajit të 6. të jetës. A i percepton ai zhurmat? A e kthen kokën, kur ju e thërrisni atë?

Orët loje dhe rraket janë veçanërisht të përshtatshme, për të zgjuar vëmendjen e foshnjës.

Flisni ju shpesh dhe shumë me foshnjën tuaj, dhe atëherë ju do ta vëreni, nëse foshnja dëgjon mirë.

Imitonи ju tingujt dhe belbëzimin e foshnjës tuaj. Tregojini ju edhe pse është foshnje e vogël, se çfarë po bëni ju momentalisht me atë. Të kenduarit dhe vjershat e rimuara pëlqehen tepër nga të gjithë fëmijët e të gjitha moshave.


Para së gjithash pas një infekzioni të veshëve të foshnjës ose të fëmijës së vogël ju duhet të shkoni patjetër për kontroll: tek konsultorja e nënave dhe baballarëve në komunën tuaj ose tek mjeku ose mjekja juaj.

5

# Unë e bëj vetë këtë!

A e keni ditur ju,  
që ...

gjuha mësohet me të  
gjitha shqisat? Jo  
vetëm dëgjimi është i  
rëndësishëm, por edhe  
prekja, shikimi, përvoja,  
marrja në dorë, ...



## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë?

Dëgjimi, shikimi, prekja, lëvizja, kuptimi, perceptimi nga lëvizja, përjetimi nga forca e rëndesës dhe shumë të tjera e ndihmojnë një foshnje, të fitojë përvojë mbi botën dhe kështu ta kuptojë atë. Kështu zhvillon aftësitë e veta emocionale, mendore dhe sociale dhe gjithashtu gjuhën e tij.

Foshnja e juaj e kuption, çfarë do të thotë «e lëmuar» ose «e ashpër», nëse lejohet të kapë sende në dorë. «E ëmbël» ose «e thartë» e mëson, kur lejohet të provojë ushqimet. Qoshet dhe këndet mund t'i vlerësojë, nëse lejohet të zvarritet. Kështu krijohen në kokën e tij koncepte mendore, që iu përkasin fjalëve.


## Shembuj për jetën e përditshme: Çfarë mund të bëni ju konkretisht për fëmijën tuaj!

Merreni foshnjën tuaj shpesh në krahë dhe lereni fëmijën t'i ndejë ledhatimet si diçka të këndshme.

Lereni foshnjën tuaj të kapë në dorë sende, t'i mbajë ato fort dhe t'i lëshojë! Jepni foshnjës të kafshojë diçkal! Lereni mundësish të provojë vetë shumë gjëra!

Kur të jetë pak më i rritur, lereni fëmijën tuaj të provojë mundësish shumë veprimitar: të zvarritet, të ecë në shtëpi, në sheshin e lojrave ose në oborr, të luajë me rërë dhe me ujë, të thërrasë dhe të këndojet, të ndihmojë në gatim, të shtrojë tavolinën, të gërmojë dheun në oborr, të mbjellë bimë. Kështu bëhet herët edhe i pavarur. Kjo ia bën më vonë veprimtarinë e përditshme në shkollë më të lehtë.

6



# Unë mundem më shumë, se sa mendoni ju!

A e keni ditur ju,  
që ...

ekziston një varësi  
ndërmjet lëvizjes,  
lojës, të ushqyerit të  
shëndetshëm, dhëmbëve  
të shëndetshëm pa  
karies dhe zhvillimit  
gjuhësor të një fëmije?

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë?

Fëmijët kanë nevojë për përvojë në  
lojë dhe në lëvizje. Të nxitësh gjuhën  
do të thotë, t'i mundësosh fëmijës  
shumë lëvizje. Duhet të lejohet të  
hidhet, të kërcejë, të ecë, të vrapojë,  
të vallëzojë, ... Gjuha dhe lëvizja janë  
të lidhura bashkë.

Kur lëvizjet e fëmijës gjatë lojës,  
sidomos lëvizjet e imta të gishtave,  
bëhen më të shkathëta, atëherë  
bëhen edhe lëvizjet e gojës dhe të  
gjuhës më të sakta.

Një formë e rregullt e dhëmbëve  
është e rëndësishme, në mënyrë që  
fëmija të mësojë edhe të flasë saktë.  
Një shqiptim i qartë bën pjesë në  
njojuritë e mira gjuhësore.

## Shembuj për jetën e përditshme: Çfarë mund të bëni ju konkretisht për fëmijën tuaj!

Lëreni ju fëmijën tuaj të ecë në  
ekuilibër mbi mure të ulëta, të hajë  
me gishta, të pijë me tuba të hollë,  
të fryjë pushin e luleve, ... Dilni ju  
shpesh në sheshin e lojrave dhe në  
natyrë. Bëni ju punëdore me fëmijën  
tuaj dhe lejojeni atë të punojë me  
gërshërë. Kur jeni edhe ju pranë nuk  
mund t'i ndodhë atij asgjë. Kështu  
fëmija mëson lëvizjet e sakta dhe  
mund ta zhvillojë fantazinë e vet.


Tregoni kujdes për dhëmbë të  
rregullta. Për këtë lëreni fëmijën tuaj  
ta përdorë biberonin vetëm deri në  
moshën 3 vjeç.

Të ushqyerit e shëndetshëm  
dhe diçka për «të kafshuar» ndërmjet  
dhëmbëve janë të rëndësishme.

Fëmija juaj nuk duhet të pijë pije të  
ëmbëlsuara. Prandaj mos e mësoni  
aspak me to!

7

# A do tē luash ti me mua?



A e keni ditur ju,  
që ...

tē folurit e tē luajturit e  
përditshëm së bashku  
sjell përparime tē mëdha  
në zhvillimin gjuhësor?

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet pér këtë?

Sa më shumë që tē merreni, tē flitni dhe tē luani ju me fëmijën tuaj, aq më shumë mund tē ndërtohen në trurin e tij struktura dhe ndërlidhje. Këto struktura dhe ndërlidhje janë vendimtare pér zhvillimin gjuhësor të fëmijës dhe pér mësimin e mëvonshëm në shkollë.

Të dëgjuarit dhe tē folurit rregullisht në një gjuhë ose në disa e ndihmon fëmijën, tē zbulojë rregullat e këtyre gjuhëve. Fëmija mund tē mësojë kështu fjalë, që zbulojnë gramatikën e gjuhës dhe mësojnë, tē komunikojnë me të tjerët në mënyrën e saktë. Në se cilën gjuhë ai ka nevojë pér shumë «ushqim» dhe duhet prandaj tē ketë mundësinë tē dëgjojë dhe tē flasë edhe vetë shumë.

## Shembuj pér jetën e përditshme: Çfarë mund tē bëni ju konkretisht pér fëmijën tuaj!

Kur ju flisni apo luani me fëmijën tuaj shkonit tek ai në nivelin e syve! Flisni direkt me fëmijën tuaj dhe i flisni atij direkt – tē paktën një çerek ore në ditë!

Flisni ju me fëmijën tuaj edhe gjatë aktiviteteve tē përditshme – p.sh. kur zhvesh këpucët dhe xhakoventën, kur vesh papuçet, kur i jepet një çaj, kur shkon në shtrat, ... Të japësh vetëm udhëzime dhe urdhëra është shumë pak!

Përdorni ju një gjuhë tē pasur. Kështu mund ta zgjerojë fëmija juaj fjalorin e tij. (Pér shembull, duke përdorur ju fjalë tē ndryshme pér tē njëjtën përbajtje: i bukur, i këndshëm, i hijshëm, ...)

Vjershat dhe këngët janë pér fëmijët në çdo moshë një burim i mrekullueshëm pér zhvillimin e fjalorit tē tij gjuhësor. Në rast se ju nuk mund t'i kujtoni më këngët dhe vjershat e fëmijërisë tuaj, atëherë pyesni prindërit tuaj ose pjesëtarë tē moshuar tē familjes ose i lexoni në një libër. Ose krijoni ju vetë vjersha dhe tregime.



# Më lër mua një herë të flas!



A e keni ditur ju,  
që ...

njeriu një fëmijë nuk  
duhet papushim ta  
korrigjojë ose të kërkojë  
prej tij ta përsërisë një  
fjalë?

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë?

Korrigimi ndrydh dëshirën për të folur. Teknika me efekt më të plotë është «përsëritja e përmirësuar».

Fëmijët nuk i tregojnë gjithmonë të gjitha çfarë dinë të bëjnë. Shpesh ato kuptojnë shumë, por akoma flasin pak. Fëmijët kanë nevojë për kohë, ashtu siç duan edhe farat kohë, që të mund të mbijnë.

Kur fëmijët rriten me dy gjuhë, atëherë mund të shquhet njëra gjuhë më fort se sa tjetra. Kjo mund të ndryshojë në ecurinë e jetës herë pas here, sipas asaj, se çfarë është momentalisht e rëndësishme në atë fazë të jetës dhe me cilën gjuhë janë të lidhura përfjetimet. Kështu për shembull mund të ndodhë tek fëmijët me dy gjuhë, që gjuha jogermane e nënës të kalojë disi në plan të tytë, kur fëmijët ndjekin kopështin gjermanofolës dhe kur shokët gjermanofolës bëhen të rëndësishëm.

## Shembuj për jetën e përditshme: Çfarë mund të bëni ju konkretisht për fëmijën tuaj!

Kur fëmija juaj shqipton diçka gabim, përsëriteni ju fjalën ose fjalinë «krejt pa rënë në sy» në formën e duhur. Mos e detyroni ta përsërisë ai të saktë.


Ruani qetësinë, kur fëmija nuk e përdor menjëherë një fjalë të re.

Keni durim! Flisni ju në gjuhën tuaj me fëmijën, edhe kur ai ju përgjigjet juve në gjuhën tjetër. Kur një fëmijë rritet me dy gjuhë, mund të ndodhë përkatësisht, që fëmija njérën nga të dyja gjuhët nganjëherë edhe për një kohë të gjatë nuk dëshiron ta përdorë në mënyrë aktive.

Kur fëmija është në një fazë të tillë, atëherë ju mos ushtroni shypje, por t'i krijoni shumë raste fëmijës, që t'i përdorë në mënyrë aktive të dyja gjuhët. Kështu ju bëni atë që duhet.



# A do të ma lexosh ti mua sot tregimin edhe më tutje?



A e keni ditur ju,  
që ...

10

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë?

Studimet shkencore tregojnë, se leximi ndikon qysh në vitet e para të jetës pozitivisht në zhvillimin gjuhësor të fëmijëve.

Leximi dhe tregimi i asaj që është lexuar e zgjerojnë fjalorin e fëmijës. Ato krijojnë një bazë të mirë për leximin dhe shkrimin, sepse gjuha e shkruar është ndryshe nga gjuha e folur, dhe gjatë leximit me zë fëmija fiton përvojë me gjuhën e shkruar dhe e mëson atë.

Fëmijët, që dëgjojnë tregime dhe mund t'i ritrej, mësojnë në këtë rast shumë gjëra, të cilat do t'i vlejnë atyre më vonë në shkollë: për shembull të mund të dëgjojnë kur flasin të tjerët, të përqëndrohen, të kujtojnë ngjarje, fjalë të reja, modele të reja fjalish dhe shumë të tjera.

leximi me zë dhe të folurit rrëth tij janë forma shumë të rëndësishme të nxitjes së gjuhës dhe se këto e parapërgatisin fëmijën tuaj mirë për shkollën?

## Shembuj për jetën e përditshme: Çfarë mund të bëni ju konkretisht për fëmijën tuaj!

Lexojini ju fëmijës tuaj nga librat me figura dhe librat me tregime – çdo ditë diçka; në gjuhën respektivisht në gjuhët, në të cilat ju flisni në shtëpi me fëmijën tuaj.


Në një numër të madh bibliotekash ju mund të merrni libra me figura dhe me tregime në gjuhë të ndryshme. Pyesni ju në bibliotekën e vendbanimit tuaj, nëse ka libra në gjuhën tuaj amtare.

Fëmijët i duan ritualet! Edhe fëmija i juaj. Tregimet para gjumit mund të bëhen si një ritual. Fëmijët kanë dëshirë, të dëgjojnë here pas here të njëjtin tregim, deri sa ato t'i kuptojnë siç duhet të gjitha dhe mundent ta ritrej. Ndihamjeni fëmijën tuaj, që të mund ta ritrej tregimin: për shembull nëpërmjet të pyeturit motivues.

Edhe nëse ju nuk dini akoma shumë mirë gjermanisht, ju megjithatë mundeni ndoshta t'i lexoni fëmijës tuaj nga librat me figura të shkruara në gjuhën gjermane.

Edhe gjyshërit dhe persona të tjera të besueshëm janë dëgjues dhe rrëfyes tregimesh të mirë.

# Të shohësh televizor? Jo faleminderit! Është shumë më bukur, kur babi dhe mami luajnë bashkë me mua!



A e keni ditur ju,  
që ...

fëmijët mësojnë më së  
miri nga loja dhe duke  
bërë gjëra së bashku dhe  
jo nga shikimi i televizorit  
ose nga kompjuteri?

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë?

Për të mësuar gjuhën, fëmijët duhet jo vetëm të dëgjojnë tingujt gjuhësorë, por edhe të kuptojnë domethënien e asaj që është thënë: Atë që shohin ta «prekin».

Të flasë mëson fëmija vetëm në kontaktin direkt me njerëzit e tjerë: me nënën dhe babain, me vëllezrit dhe motrat, në familjet më të mëdha dhe më vonë me shoqet dhe shokët.

Filma të mirë për fëmijë, që shikohen së bashku me prindërit, janë shumë të këshillueshëm. Shikimi i televizorit ose loja në kompjuter për orë të tëra janë të dëmshme. Fëmijët mësojnë pak kështu.


## Shembuj për jetën e përditshme: Çfarë mund të bëni ju konkretisht për fëmijën tuaj!

Lëreni fëmijën tuaj të ketë pjesën e vet në ngjarjet e përditshme.

Jepini atij rastin, që fjalët e reja t'i perceptojë me duar. Të ndihmuarit gjatë gatimit dhe pjekjes, loja me ujë, rërë dhe gurë ose plastelinë janë më të përshtatshme, për të përkrahur zhvillimin e fëmijës, se sa televizori.

Kur fëmija juaj shikon televizor, atëherë ju duhet të zgjidhni një film dhe të flisni me fëmijën tuaj për atë çfarë ndodh. Kështu fëmija kupton më mirë dhe mëson edhe fjalë të reja.

Në bibliotekë ju mund të huazoni shumë filma të mirë. Kështu ju mund t'i krijoni fëmijës tuaj variacion me shpenzime të volitshme dhe frymëzime të reja.



# Unë dëshiroj të jem bashkë edhe me fëmijët e tjerë!

A e keni ditur ju,  
që ...

fëmijët mund të mësojnë shumë mirë gjermanisht, në rast se ato herët e kanë një shoqe apo një shok me këtë gjuhë ose shkojnë në grupin e lojrave ose në kopësht?

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë?

Njohuritë e mira të gjermanishtes janë të rëndësishme për fëmijën tuaj: për jetën e tij, për të shkuar me dëshirë në shkollë dhe për të patur shanse të mira në fushën e profesionit.

Për të mësuar mirë gjermanisht, fëmija juaj ka nevojë për mundësi të shumëlojshme, ta dëgjojë dhe ta flasë këtë gjuhë, dhe një motivim të mirë për këtë. Shoqet dhe shokët, që flasin mirë gjermanisht, janë një motivim shumë i mirë.

Ndjekja e rregullt e një grupei të lojrave ose e kopështit që nga mosha tre-vjeçare, i jep kohë fëmijës, që ta forcojë gjuhën gjermane deri në fillimin e shkollës dhe të parapërgatitjet për kërkesat e shkollës. Edhe nëse gjuha familjare e tij nuk është gjermanishtja, fëmija juaj mund ta mësojë këtë gjuhë shumë mirë, në rast se ai e shfrytëzon këtë mundësi.

## Shembuj për jetën e përditshme: Çfarë mund të bëni ju konkretisht për fëmijën tuaj!

Përkraheni fëmijën tuaj, kur dëshiron të vizitojë ose të ftojë në shtëpi shoqe dhe shokë. Fëmijët i mësojnë gjuhët, të cilat janë të rëndësishme për ta në jetën e përditshme, zakonisht shumë shpejt.

Regjistrojeni fëmijën tuaj që në moshën dyegjysëm deri në tre-vjeçare në një grup lojrash. Në këtë moshë fëmijët janë në shumicën e rasteve mjaft të pjekur për këtë dhe gëzohen për shoqet e reja dhe shokët e rindë si edhe për lojrat dhe aktivitetet me fëmijët e tjera.

Edhe vizitimi më i hershëm i një institucioni të përkujdesjes për fëmijët është i mundshëm, në rast se ju këtë e keni të nevojshme për shkak të profesionit ose vendosni për këtë duke u nisur nga arsyetime pedagogjike.

Nëse ju në shtëpi me fëmijën tuaj flisni një gjuhë të ndryshme nga gjermanishtja, mund ta parapërgatitni fëmijën në formë loje në gjermanisht si një gjuhë e re, që ai do ta njohë në grupin e lojrave ose në kopësht. Flisni ju me fëmijën për këtë, bëjeni atë kureshtar, mësojani atij nocione të thjeshta, të cilat mund t'i duhen në mëdisin e tij të ri.

Transmetojani ju fëmijës, se është e mrekullueshme, nëse ai mund të flasë disa gjuhë.

12



**Edhe diçka që ne dëshirojmë  
t`jua vëmë në zemër ...**



**Gjuhët, për të cilat ne nuk investojmë, humbasin.**  
Ne duhet një gjuhë ta kultivojmë dhe ta përdorim,  
për të mos e harruar atë.

Kur fëmija juaj do të shkojë në kopësht dhe pastaj më vonë në shkollë, gjermanishtja do të bëhet një gjuhë e rëndësishme përfëmijën.  
Për këtë ka nevojë për nxitjen dhe përkrahjen tuaj. Por mos harroni ju, të kultivoni gjuhën tuaj ose gjuhën e familjes.

Në shkollë është mësimi në gjuhën dhe kulturën e atdheut (HSK) një mundësi e mirë, për ta nxitur më tutje gjuhën e parë. Informohuni përfkaktësisht përmes rrjetave sot vendimtar përfshirë pozicionin e një njeriu në fushën e profesionit dhe në shoqëri.

Lexoni ju vetë gazeta dhe/ose libra dhe flisni mbi temat e reja me fëmijën tuaj! Kështu i zhvilloni ju dhe fëmija gjuhët tuaja më tej.

Motivojeni fëmijën tuaj, të lexojë shumë – në gjermanisht dhe në gjuhët e tjera.

**Përkrah gjuhës gjermane dhe asaj angleze**  
të zotërojë mirë edhe një gjuhë tjetër, kjo i sjell fëmijës tuaj shanse në profesion.

Gjuha është një thesar – secila gjuhë. Vlera rritet, sa më shumë që zhvillohet dhe kultivohet ajo. Zotërimi i mirë i gjuhëve është sot vendimtar përfshirë pozicionin e një njeriu në fushën e profesionit dhe në shoqëri.

# Institucionë dhe oferta për këshillimin dhe mbështetjen e prindërve

## Elternberatung Graubünden (Këshillimi i prindërve)

Këshillim për prindër të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël. Informohuni në komunën tuaj të banimit për ofertën në regionin tuaj.

## Administrata e komunës

Informacione mbi përkujdesjen e fëmijëve, grupet e lojës dhe kopshtet e fëmijëve në vendbanimin tuaj ju merrni në komunën tuaj.

## Biblioteka dhe ludoteka

Biblioteka dhe ludoteka për huamarrjen e librave dhe lojërave ju gjeni në shumë vende. Pyesni në bibliotekën tuaj, nëse janë të pranishëm gjithashtu libra për fëmijë në gjuhën tuaj të parë ose të familjes.

## Mundësi të të mësuarit për fëmijë deri në 4 vjeç

Mbi 60 filma të shkurtër me sugjerime dhe ide, si mund t'i nxisin prindërit fëmijët e tyre në situata të jetës së përditshme. Mund të shihen në 13 gjuhë.

[www.kinder-4.ch](http://www.kinder-4.ch)

## Aplikacione familjesh dhe prindërish

Ka shumë aplikacione praktike që mbështesin prindërit në fusha të ndryshme në jetën e përditshme familjare. Disa prej tyre janë shumëgjuhëshe dhe falas.

- *Parentu – Këshilla për prindër të fëmijëve ndërmjet 0 dhe 16 vjeç*
- *Kleine Weltentdecker (Eksploruesit e vegjël të botës) – Këshilla për prindër të fëmijëve të vegjël*

## Elternbildung Graubünden (Formimi për prindër Graubünden)

Shoqata «Elternbildung Graubünden – Formim për prindër Graubünden» ofron një ofertë të shumëlojshme formimi për prindër dhe edukues.

[www.elternbildung-gr.ch](http://www.elternbildung-gr.ch)

## famur – për familjet në Graubünden

Ndërmjetëson oferta shtesë dhe mbështetëse për familjet si familjet ditore, përkujdesëse për fëmijë, kopshte ditorë fëmijësh dhe shoqërimë sociale familjesh.

[www.famur.ch](http://www.famur.ch)

## **Heilpädagogischer Dienst Graubünden (Shërbimit kurues pedagogjik Graubünden)**

Tek shërbimi kurues pedagogjik ju mund të sqaroni vendndodhjen e zhvillimit të fëmijës suaj dhe merrni përgjigje ndaj pyetjeve për zhvillimin e personalitetit fëmijëror dhe për edukimin. Fëmija juaj merr mbështetje me pikësynim në lojë dhe në veprimet që kanë të bëjnë me jetën e përditshme dhe mund t'i zgjerojë kështu aftësitë e tij.

[www.hpd-gr.ch](http://www.hpd-gr.ch)

## **Schulpsychologischer Dienst/ Schul- und Erziehungsberatung (Shërbimi psikologjik shkollor/ Këshillim për shkollën dhe edukimin)**

Shërbimi psikologjik shkollor me vendet e tij rajonale për këshillimin për shkollën dhe edukimin ju qëndron juve në krah për pyetje psikologjike dhe probleme në rrethin e edukimit dhe të shkollës.

[www.avs.gr.ch](http://www.avs.gr.ch)

## **Kinder- und Jugendpsychiatrie Graubünden (Psikiatri për fëmijë dhe të rinj Graubünden)**

Psikiatria për fëmijë dhe të rinj në Graubünden është një institucion medicinal dhe ofron sqarime dhe trajtime të fëmijëve dhe të rinjve me çrregullime psikike, psikosomatike dhe psikosociale.

[www.kjp-gr.ch](http://www.kjp-gr.ch)

## **Beratungsstelle Opferhilfe Graubünden (Vendi i këshillimeve – ndihmë për viktimat Graubünden)**

Nëse një fëmijë tregon shenja të zbatimit të dhunës ndaj tij, zyra e këshillimeve për ndihma ndaj viktimate (Beratungsstelle Opferhilfe) Graubünden numd të kontaktohet për këshilla dhe mbështetje profesionale.

[www.soa.gr.ch](http://www.soa.gr.ch)

## **Elternnotruf (Telefon emergjent për prindërit)**

Edukimi i fëmijëve është shpesh për prindërit një sfidë e madhe. Telefonii emergjent për prindërit ofron përgjatë 24 orësh këshilla dhe ndihmë falas nëpërmjet telefonit ose e-mailit në rast të pyetjeve për edukimin, rastet e konflikteve ose krizave në familje.

**0848 35 45 55**  
[www.elternnotruf.ch](http://www.elternnotruf.ch)



Kanton Graubünden  
Chantun Grischun  
Cantone dei Grigioni

Amt für Migration und Zivilrecht  
*Fachstelle Integration*



Porosi:

Fachstelle Integration Graubünden  
Grabenstrasse 1  
7001 Chur

📞 081 257 26 38  
✉️ info@integration.gr.ch

[www.integration.gr.ch](http://www.integration.gr.ch)  
[www.hallo.gr.ch](http://www.hallo.gr.ch)

(Albanisch)